



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:180849
Datë: 22.07.2024
Numri i dokumentit: 05965245

C-III.-24-0092

Paditës - Propozues:

Autoriteti i Likuidimit të NSH “Produkt” – Skënderaj, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishtë.

Kundër:

Të paditura – Pala kundërshtare:

Komuna e Skenderajt, Skenderajt, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesi ligjor E Ç.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtari Dr.sc. Murat Hulaj- kryesues kolegji, Hajrie Shala dhe Hasim Sogojeva, anëtar kolegji-gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.22 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- APROVOHET** si e bazuar Kërkesa për Masë të Sigurimit dhe i **NDALOHET** të paditurës / kundërshtares së sigurimit Komunës së Skenderajt që parcelën kadastrale P...me sip. prej 00.88.48 ha ZK Ç K. Skenderaj, e evidentuar në emër të NSH.”Produkt”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit(AKP), të vazhdoj punimet, të marr çfarëdo veprimi juridik lidhur me ndërtimin apo shitblerjen – bartjen e pronësisë në persona të tretë, lënien në hipotekë dhe peng si dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrat e paluajtshmerive, deri në vendimin përfundimtar të DHPGJS përfshirë edhe vendimin e Kolegjit të Apelit në rast të ndonjë ankese.
- Nuk caktohen taksat gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.27 qershor 2024, paditësja ka paraqitur në gjykatë padi kundër të paditurës, me objekt të kontestit lirim i pronës, kthim në gjendjen e mëparshme si dhe kompensim i dëmit material, me propozim për caktimin e masës së sigurisë. Në padi ka pohuar se parcela kadastrale P-..me sip. prej 8848m2 ZK Ç K. Skenderaj, objekt i kontestit në këtë çështje është pronës shoqërore e NSH “Produkt”- Skenderaj. E paditura pa pëlqimin dhe pa dijen e paditëses e ka bërë rrënimin e objekteve / lokaleve pronë e NSH-së. Paditësja i ka kërkuar Drejtorisë së Inspeksionit që ti ndërprerë punimet, po kjo kërkesë nuk është marr parasysht. Nga vizitat të cilat janë bërë nga zyrtarët e AKP-së, është vërtetuar se veprimet e kundërligjshme janë bërë nga K. Skenderajt. E paditura ka qenë në dijeni se këto prona janë pronë shoqërore.

Ka shtuar se ekziston rreziku që paluajtshmëria të jetë objekt i shitjes ose ndonjë keqpërdorimi eventual, dhe konsideron se të gjitha kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurisë. Si dhe pa caktimin e masës së sigurisë paditësja do të pësoj dëme të menjëhershme dhe të pa riparueshme. Ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme e sigurisë dhe ti ndalohet të paditurës menjëherë vazhdimi i punimeve, marrja e çfarëdo veprimi juridik lidhur me ndërtime apo shitblerjen – bartjen e pronësisë në persona të tretë, lënien me hipotekë dhe peng si dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrat e paluajtshmerisë me parc.kd.nr...me sip. prej 8848 m2 ZK Ç K. Skenderaj. Së bashku me padi i ka bashkangjitur këto prova: Certifikata e pronësisë dt..., Kërkesë për ndërprerje të punimeve në parcelën ..ZK Ç, Dy foto, Raport i vizitës në teren dt.13.05.2024

E paditura Komuna e Skenderajt përmes të autorizuarit të saj me dt.10 qershor 2024, ka paraqitur përgjigje në padi ku ka pohuar se e kundërshton kërkesëpadinë dhe kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, pasi që e njëjta është në kundërshtim me interesat e qytetarëve të K. Skenderajt, pra me interesin e përgjithshëm. Prona të cilën e pretendon AKP është një zonë e banuar dhe qytetarët e shfrytëzojnë, punojnë dhe veprojnë në ato lokale. Zyra e kryetarit të komunës si dhe Drejtorisë së Gjeodezisë me dt.27.06.2024, kanë konstatuar se hapësira e planifikuar prej 88.84 ha, në pronësi të OPB “Produkti” nuk ka arritur që ti shmangët projektit për ndërtimin e Subqendres në Ç dhe kjo pronë do të kompensohet përmes procedurës së këmbimit/shpronësimit të pronës komunale.

Me marrëveshjen për zhvillim parashihet një projekt infrastrukturor i cili është përfundim e sipër dhe kjo dëshmohet përmes marrëveshjes së lidhur mes komunës së Skenderajt dhe kompanisë “S”. Në dhjetor të vitit 2022 Gjykata Supreme e ka aprovuar masën e përkohshme edhe pse projekti ka qenë në përfundim të punimeve. Asambleja Komunale ka nxjerr vendim për shpronësim e cila është dërguar për aprovim në nivelin qendror si dhe në AKP. Nivelin qendror ka marr vendim dhe disa prona kanë kaluar në pronësi të komunave, kurse vendimi i Qeverisë së Kosovës dt.30.04.2022 e ka shfuqizuar këtë vendim për shkak të çështjeve ligjore, dhe komuna ka marr veprimet juridike dhe parcela përsëri ka kaluar në emër të NSH-së. Nëse vendoset sipas kërkesës së AKP-së dhe të bëhet kthimi në gjendjen e mëparshme atëherë do të shkaktohen pasoja financiare që do të ishin shumëfish më të larta se kompensimi i punëtorëve, kompensimi – shpronësimi i pronës kontestuese. Investimi kapital i bërë nga komuna në këtë zonë tejkalon vlerën e pronës si dhe kompensimin e punëtorëve të ndërmarrjes prej 20%. Lidhur me caktimin e masës së sigurisë nuk janë përmbushur kushtet ligjore. I ka bashkangjitur këto prova: Kontratë nr... dt..., Kushtet e përgjithshme nr. i kontratës..., Kushtet e veçanta nr. i kontratës ..., Garanci Ekzekutimi polica nr.10000566037 – Prisig, Vendim për shpallje të pronës me interes publik nr... dt..., Propozim nr.02-463/09-029523/24 dt.27.06.2024, Konstatim nr.02-463/01-0029524/24 dt.27.06.2024, Certifikatë e pronës parc.kad.nr...dt..., Kopja e planit e

parc.kad.nr..., Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.prot.3900-2/24 dt.05.07.2024, Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.prot.3901-3/24 dt.05.07.2024, Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.prot... dt..., Kërkesë për ndërprerjen e punimeve në parc.kad.nr...ZK Ç, Foto, Raport i vizitës në teren dt.08.04.2024, Raport i vizitës në teren dt.13.05.2024, Certifikata e pronësisë dt..., Njoftim reference 19803/2024 dt.23.06.2024.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për masë të sigurimit është e bazuar.

Sipas nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cila kërkon urdhër paraprak gjyqësor duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tekë paditësit, kështu që paditësit përveç që duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Ekzistimi i së drejtës së pretenduar

Për të përcaktuar kushtet paraprake rreth miratimit të Masës së Sigurimit, Kolegji konsideron se në mënyrë që të miratohet masa e sigurimit mjafton nëse paditësi vetëm dëshmon në kuptim të *probatio semiplena* një mundësi të lartë se padia e tij është e bazuar, përkatësisht, se e drejta e pretenduar ekziston.

Për ta vërtetuar këtë gjendje mjafton vetëm referimi te Certifikata e pronësisë, në bazë të së cilës paditësja është pronare e parcelës kadastrale e cila është objekt i këtij kontesti.

Pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur mbi padinë, bazuar në dokumentet e paraqitura, *probatio semiplena*, për natyrën e pretenduar juridike si dhe mbi atë se a duhet të bëhet apo jo lirimi i parcelës kadastrale dhe rikthimi në gjendje të mëparshme e kompensimi i dëmit material të shkaktuar, Gjykata konstaton se parakushti mbi provat e besueshme është plotësuar.

Dëmi i menjëhershëm

Kolegji vlerëson se dëmi mund të jete i menjëhershëm ngase e paditura disponojnë me pronën kontestuese dhe pasi që e njëjta ka ndërmarrë veprime në këtë parcelë pa e bërë shpronësimin e saj si dhe pa lejen paraprake të paditëses.

Në këtë rast gjykata ka gjetur se kërkesa e paditësit për Masë të Sigurimit ka mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj kërkesa si e tillë u aprovua.

Shpenzimet Gjyqësore

Paditësi tani më ka paguar taksën gjyqësore për kërkesën për masë të sigurimit në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme Brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Dr.sc.Murat Hulaj, Gjyqtar kryesues _____

Hajrie Shala, Gjyqtare _____

Hasim Sogojeva, Gjyqtar _____